



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Nr. 01.031-1078 dt: 21.01.2015



VENDIM PËR LEJIMIN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

Nga: Zyrtari për Qasje në Dokumente Publike

Për: Organizatën për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet "ÇOHU"

Të nderuar,

Me qëllim të përgjigjes në kërkesën tuaj për lejimin e qasjes në dokumente publike, me numër protokollit 01.031-1078 të datës 08.01.2015, në pajtim me nenin 4, pika 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregullores Komunale për Transparencë neni 9 pika 1,2,3 dhe 4; Ju informojmë si në vijim:

1. Ju lejohet qasje e plotë në dokumentin e kërkuar.
2. Dokumenti i kërkuar do t'ju ofrohet nga Komuna e Drenasit.
3. Qasja në dokumentin e kërkuar do t'ju mundësohet sipas mënyrës së kërkuar në kërkesën tuaj (përmes e-mail-it) konform dispozitave ligjore.

Zyrtari për qasje në dokumente publike

Bekim Dobra



Bekim Dobra

Bekim Dobra

From:
Sent:
To:
Subject:

Majlindë Lulaj [mlulaj@ombudspersonkosovo.org]
Tuesday, January 20, 2015 3:52 PM
Bekim Dobra

Institucioni i Avokatit të Popullit - përgjigje në kërkesën për këshillë lidhur me QDP

I nderuar Bekim,

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka shqyrtuar me kujdes kërkesën tuaj për këshillë lidhur me kërkesën e "ÇOHU" për qasje në dokumente "[...]në të gjitha patundshmëritë [...]" e personave të përmendur në vetë kërkesën e parashtruar, ashtu si edhe në email-in tuaj! IAP e konsideron të arsyeshme dilemën tuaj!

Vlerësimi IAP-së lidhur me rastin në fjalë është bërë mbi bazën e Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, në mënyrë të veçantë Nenin 12 (paragrafit 1, pika 1.6, **me te cilin kufizohet e drejta e qasjes për qëllime të mbrojtjes së privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat**; paragrafin 2 të Nenit 12, **me të cilin bëhet refuzimi i qasjes në informata, nëse zbulimi i tyre dëmton cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1 të po këtij neni, përveç kur ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të ofruar qasjen**; paragrafin 3, **sipas të cilit nëse vetëm një pjesë e dokumenteve të kërkuara përfshihen në përjashtimet e përmendura në paragrafin 1 të Nenit 12 (Kreu III) të LQDP-së, pjesët e mbetura bëhen publike**).

Përkundër faktit se IAP nuk është në dispozicion të dokumenteve eventuale që Komuna e Drenasit disponon për personat në fjalë (llojin e dokumenteve të kërkuara për qasje nga "ÇOHU"), në parim, konsiderojmë se qasja në cilindo dokument eventual të patundshmërisë(ve) të personave që janë subjekt i kërkesës (meqenëse ata janë persona që mbajnë poste publike, në bazë të të dhënave që na i keni dërguar), mund të ofrohet e pjesëshme. Kjo nënkupton se në dokumentet e kërkuara duhet të mbulohen të gjitha të dhënat që cenojnë privatësinë e personave në fjalë, përderisa mbeten të qasshme vetëm të dhëna që pohojnë posedimin e patundshmërisë.

Nëse eventualisht mund të keni dilema të mëtutjeshme sa i përket ofrimit të të dhënave dhe konsideroni se ato mund të dëmtojnë privatësinë e personave për të cilët kërkohen të dhënat, ju lutemi drejtohuni në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vlerësim të detajuar të rastit në fjalë.

Me respekt,

Majlinda Sinani Lulaj
Institucioni i Avokatit të Popullit / Ombudsperson Institution
Udhëheqëse e Zyrës për Media / Head of Media Office
Zëdhënëse / Spokesperson

mlulaj@ombudspersonkosovo.org
mob.: + 377 (0) 44 827 844
<http://www.ombudspersonkosovo.org/>

----- Forwarded message -----

From: **Bekim Dobra** <Bekim.Dobra@rks-gov.net>
Date: 2015-01-19 11:38 GMT+01:00
Subject: FW: IAP - kërkesë për sqarime shtesë, lidhur me kërkesën e ÇOHU për QDP
To: Majlindë Lulaj <mlulaj@ombudspersonkosovo.org>